



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**Raport i punës**  
**së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës**  
**për Shërbimin Civil të Kosovës për**  
**vitin 2019**

Prishtinë  
Mars 2020

**FJALA E KRYETARIT TË KËSHILLIT TË PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS, ESHREF SHABANI**

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë, që të prezentoj Raportin vjetor të punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2019. Ky raport, pasqyron kryerjen e funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit për mbikëqyrjen e respektimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e Republikës së Kosovës që kanë të punësuar shërbyes civilë.

Këshilli me profesionalizëm është angazhuar që të mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil nga institucionet e administratës publike të nivelit qendror dhe lokal dhe është dëshmuar si institucion që ka punuar me përkushtim, në mënyrë të paanshme, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin, duke kontribuar nga fushëveprimtaria e tij, që shërbimi civil të jetë profesional dhe i paanshëm, si dhe të pasqyrojë diversitetin e popullit të Kosovës, duke përfshirë parimin e barazisë gjinore.

Në raportin vjetor të punës, përfshihen të dhëna për punët e kryera në kuadër të funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes për ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, funksionit të mbikëqyrjes së procedurës së përzgjedhjes dhe vendosjes në emërimet e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe nivelit drejtues si dhe funksionit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, përfaqësimin e Këshillit në procedura gjyqësore, bashkëpunimin e Këshillit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare si dhe pjesëmarrjen e Këshillit në konferenca dhe takime të rëndësishme lidhur me proceset reformuese në administratën publike.

Viti 2019 ka qenë sfidues për Këshillin, pasi që kemi pasur numër të madh të ankesave. Në vlerësojmë, që numri i madh i ankesave, nuk është pasojë e shkeljeve më të shumta në shërbimin civil, se në vitet paraprake, por është një vetëdijesim më i madh i nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, që të shfrytëzojnë të drejtën e ankimimit në rastet kur vlerësojnë që ju kanë cënuar të drejtat nga marrëdhënia e punës si dhe një besim i shtuar në vendimmarrjen e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Më këtë rast, falënderoj anëtarët e Këshillit për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar, duke bërë që Këshilli të vendos për të gjitha ankesat, brenda afateve të përcaktuara me ligj. Po ashtu, falënderoj drejtorin ekzekutiv, bashkëpunëtorët profesional dhe nëpunësit tjerë të sekretarisë, që kanë ofruar mbështetjen e tyre profesionale dhe administrative, si rezultat i së cilës kemi arritur që t'i realizojmë me sukses funksionet e Këshillit.

Këshilli gjatë këtij viti raportues në kuptim të zbatimit të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda një afati optimal, ka nxjerr pesë akte nënligjore të përcaktuara me nenin 30 të këtij Ligji.

Me datë 02.11.2018, Avokati i Popullit ka dërguar Ligjin Nr.06/L-48 në Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë të disa neneve të këtij ligji.

Gjykata Kushtetuse e Republikës së Kosovës me datë 02.05.2019 ka nxjerrë aktgjykimin me Nr.ref.AGJ 1363/19, me të cilin aktgjykim ka shpallur si jo kushtetues disa nene të këtij ligji.

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës gjatë vitit 2019 është ballafaquar me një situatë të vështirë për shkak të moszgjidhjes së anëtarëve të KPMSHCK-së nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Me datë 19 dhjetor 2018 katër anëtarëve të KPMSHC ju ka skaduar mandati prej pesë vitesh, Këshilli ka vazhduar punën me një Kolegj, gjegjësisht me tre anëtarë, deri me datë 21.01.2019 kur njëra anëtare është emëruar gjyqetare në sistemin e drejtësisë dhe rrjedhimisht KPMSHCK ka mbetur pa kourm për vendimarrje dhe nuk ka mundur ta ushtrojë asnjë funksion të paraparë me dispozita ligjore.

Prandaj të gjitha ankesat e parashtruara nga ankuesit gjatë vitit 2019 nuk kanë arritur të zgjidhen si pasojë e mungesës së kourimit.

Unë konsideroj se Komisioni i Administratës Publike duhet ta rishqyrtojë edhe një herë interpretimin e datës 19.12.2018 nr.7801/2018, i cili ka interpretuar nenin 10 paragrafin 7 të Ligjit Nr.06/L-48, ngase ky interpretim ka shkaktuar mosfunksionimin e KPMSHCK, sepse në pamundësi të zgjedhjes së anëtarëve të KPMSHCK do të duhej që anëtarët aktualë të vazhdonin mandatin deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinjë.

Është imediate që Kuvendi i Republikës së Kosovës të bëjë zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për arsye se pas datës 07.04.2019 në KPMSHC nuk do të ketë më asnjë antarë të emëruar, sepse të gjithëve ju skadon mandati dhe rrjedhimisht mbetet vetëm Sekretaria e KPMSHCK-së.

**Eshref Shabani**

**Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**

**TABELA E PËRMBAJTJES**

	Fjala e kryetarit të Këshillit	2
1.	Përmbledhje ekzekutive	5
2.	Korniza ligjore	6
3.	Fushëveprimi i Këshillit	6
4.	Organizimi i Këshillit	7
5.	Aktivitetet e Këshillit për periudhën raportuese	9
5.1.	Funksioni i shqyrtimit të ankesave	9
5.1.1	Ankesat e pranuar sipas objektit	9
5.1.2	Ankesat e pranuar sipas strukturës gjinore të ankuesve	11
5.1.3	Ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve	12
5.1.4	Ankesat e pranuar sipas institucioneve ndaj vendimeve të të cilave është paraqitur ankesë	13
6.	Ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve	15
6.1	Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore	15
6.2	Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale	23
7.	Ndarja e ankesave sipas formës së vendosjes	25
7.1.	Të aprovuara	25
7.2.	Pjesërisht të aprovuara	25
7.3.	Të refuzuara	25
7.4.	Të hedhura poshtë	25
7.5.	Të shpallura jo-kompetent	25
7.6.	Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ	26
7.7.	Kthimi në rishqyrtim	26
7.8.	Përfundim i procedimit administrativ	26
8.	Formate vendosjes kundër vendimeve të institucioneve	27
8.1.	Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore	27
8.2.	Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale	29
9.	Zbatimi i vendimeve të Këshillit nga organet e punësimit	30
10.	Funksioni i vëzhgimit të procedurës së emërimit të nëpunësve civil të nivelit drejtues	33
11.	Funksioni i mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil	35
12.	Rekomandimet dhe sfidat e Këshillit	34
13.	Vendimet e Gjykatave	34
14.	Bashkëpunimi i Këshillit me institucionet e tjera	36
15.	Krahasimi i punës së Këshillit për vitin 2018 me punën e Këshillit për vitin 2019	36
16.	Raporti për shpenzimin e buxhetit të Këshillit	39

## 1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i punës për vitin 2019, përmban të dhëna dhe informata të detajuara për të gjitha aktivitetet dhe punët e kryera nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në raport përfshihen të dhëna për punët e kryera në kuadër të funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes për ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, funksionit të mbikëqyrjes së procedurës së përzgjedhjes dhe vendosjes për emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe nivelit drejtues si dhe funksionit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Po ashtu, në këtë Raport janë përfshirë edhe aktivitetet tjera të Këshillit, si përfaqësimi i Këshillit në procedura gjyqësore, bashkëpunimi i Këshillit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrjen e Këshillit në konferenca dhe takime të rëndësishme lidhur me proceset reformuese në administratën publike .

Këshilli gjatë vitit 2019, ka pranuar gjithsejtë 784 ankesa, si dhe ankesat që kanë qenë të bartura nga viti 2018 në vitin 2019, 112 sosh që gjithsejtë për shëyrtrim ka pasur 896 ankesa.

Këshilli prej ankesave të pranuar dhe të bartura nga viti paraprak, ka vendosur për 49 ankesa, prej tyre 48 janë ankesa që janë vendour që kanë qenë të bartuara nga viti 2018, ndërsa vetëm për një ankesë të pranuar në vitin 2019 është vendosur.

Këshilli ka mbetur pa vendimmarrje në funksionin e mbikëqyrjes dhe monitorimit sepse nuk ka pasur kuorum për vendimmarrje, ndërsa ka pasur vetëm një koleg prej tre anëtarëve i cili ka nxjerr vendime vetëm në funksionin e ankesave deri me datën 21 janar 2019, ku më këtë datë nga Këshilli ka dhënë dorëheqje anëtarja nga përkatësia etnike serbe, pasi që është emëruar gjyqtare në gjykatë të rregullt dhe nga kjo datë, Këshilli ka mbetur plotësisht jashtë funksionit, edhe pse Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka zhvilluar disa procedura të zgjedhjes së anëtrve të rinj por të njëjtit nuk janë zgjedhur.

Në kuadër të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civilë, Këshilli nuk ka pasur plan të monitorimit të aprovuar pasi që nuk ka pasur anëtar për të vendosur, si rrjedhojë në vitin 2019 nuk është realiuar asnjë vizitë monitoruese nga ana e Këshillit.

## 2. KORNIZA LIGJORE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kryen funksionet dhe përgjegjësitë në pajtim me:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës,
- Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
- Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë;
- Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregulloren Nr.03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Mbikëqyrjes së Përzgjedhjes të nëpunësve Civil të Lartë Drejtues dhe Nivelit Drejtues;
- Rregulloren Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil; dhe
- Rregulloren Nr. 05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

## 3. FUSHËVEPRIMI I KËSHILLIT

Këshilli është organ i pavarur i cili mbikëqyr respektimin e të gjitha rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, nga ana e institucioneve të administratës publike. Këshilli për punën e tij i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është paraparë me nenin 101 paragrafin 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ndërsa kompetenca dhe përgjegjësit e tij janë të rregulluara me Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe duke ju referuar Aktgjyqimit me Nr. Ref. AGJ.1363/19 të datës 20.05.2019 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, janë përcaktuar funksionet e Këshillit si në vijim:

- shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil.
- monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civilë, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve, Këshilli mund të:

- vizitojë çdo vend ku janë të punësuar nëpunësit civilë;
- ketë qasje dhe të kontrolloj dosjet dhe çdo dokument lidhur me zbatimin e rregullave

- dhe parimeve te legjislacionit për shërbimin civil;
- intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit;
  - kërkon dhe merr nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave te tij
  - organizon seanca profesionale; dhe
  - nxjerr vendime, udhëzime qëndrime dhe rekomandime.


#### **4. ORGANIZIMI I KËSHILLIT**

Organizimi i brendshëm i Këshillit është i rregulluar me Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe me Rregulloren Nr.05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me dispozitat e këtij Ligji është përcaktuar edhe përbërja e Këshillit, ku përcaktohet që Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, që emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente me mandat 7 vjeçar me pamundësi rizgjedhje, po ashtu përbërja e Këshillit pasqyron karakterin shumë etnik dhe gjinor të Republikës së Kosovës.

Sekretaria e Këshillit i ofron mbështetje administrative dhe profesionale-juridike Këshillit në ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore. Sekretaria udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe ka të punësuar 23 nëpunës civilë. Në kuadër të Sekretarisë funksionon Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme dhe Divizioni për Mbështetje Profesional

**Organogrami i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**





## 5. AKTIVITETET E KËSHILLIT PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE

Në vijim të raportit, paraqesim një pasqyrim të plotë të mënyrës së ushtrimit të funksioneve nga Këshilli, respektivisht për procesin e shqyrtimit të ankesave, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë periudhës raportuese 1 Janar -31 Dhjetor 2019.

### 5.1.FUNKSIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Këshilli gjatë vitit 2019 ka pranuar gjithsej 784 ankesa të cilat janë parashtruar nga nëpunësit civilë, si dhe nga kandidatët për pranim në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli, përveç 784 ankesave të pranuar, në shqyrtim ka pasur edhe 112 ankesa, të cilat janë bartur nga viti 2018 për vendosje në vitin 2019. Bazuar në këto të dhëna, rezulton që Këshilli gjatë vitit 2019 ka pasur në shqyrtim gjithsej 896 ankesa.

Nga 896 ankesa të pranuar për shqyrtim gjatë vitit 2019, Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore për 49 ankesa, ndërsa 847 ankesa kanë ngelur pa u vendosur brenda afatit ligjor, kjo për shkakun e mos emërimit të pesë (5) anëtareve të Këshillit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këshilli funksionin e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave e ka ushtruar nga data 01.01.2019 deri më 21.01.2019, kur nga Këshilli ka dhënë dorëheqje anëtarja nga përkatësia etnike serbe, Lela Petkoviç pasi që është emëruar gjyqtare në gjykatë të rregullt dhe nga kjo datë, si rrjedhojë e kësaj Këshilli nuk ka mundur që ta ushtroj funksionin e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave.

Ky raport përmban të dhëna statistikore për ankesat e pranuar sipas:


1. objektit të ankesës:
2. strukturës gjinore të ankuesve:
3. strukturës etnike të ankuesve: dhe
4. institucioneve ndaj vendimeve të të cilave është paraqitur ankesë:

#### 5.1.1.Ankesat e pranuar sipas objektit të ankesës


Në Këshill, janë pranuar ankesa, të cilat kanë pasur objekt të ndryshëm të ankimimit dhe të ndara sipas llojit të objektit. Ndarja e ankesave sipas objektit pasqyrohet në numra dhe në përqindje në tabelën në vijim :

Nr.	Objekti i ankesave	Numri i ankesave	Përqindja
1	Kontestim konkursi	405	51.65%
2	Kompensim material	97	12.37%
3	Kërkesa nga marrëdhënia e punës	86	10.96%
4	Ndërprerje e marrëdhënies së punës	53	6.76%
5	Masë disiplinore	53	6.76%
6	Transferime	47	5.99%
7	Vlerësim i punës	13	1.65%
8	Pezullim parandalues	13	1.65%
9	Shkelje e të drejtës në pagë	7	0.89%
10	Moszbatim i vendimeve të komisionit të ankesave	4	0.51%
11	Pezullim i dakorduar	2	0.25%
12	Ulje në pozitë	2	0.25%
13	Kundër caktimit të ushtruesit të detyrës	1	0.12%
14	Çështje të avancimit në karrierë	1	0.12%
	Gjithsejtë:	784	100%

Tabela nr. 1 paraqet ankesat e pranuar sipas objektit të ankesës në vitin 2019



Diagrami nr.1 paraqet të dhënat e tabelës nr.1




**Vazhdim i diagramit nr.1**

#### 5.1.2. Ankesat e ushtruara sipas strukturës gjinore të ankuesve

Nga 784 ankesa të pranuar në vitin 2019, ndarja sipas strukturës gjinore të ankuesve është si në vijim: ankues meshkuj kanë qenë 533 ose 67.98%, ndërsa ankuese femra kanë qenë 251 ose 32.02%.

Nr. Rendor	Ankesat e ushtruara sipas strukturës gjinore	Numri	Përqindja
1	Meshkuj	533	67.98%
2	Femra	251	32.02%

**Tabela nr. 2 paraqet ankesat e pranuar sipas strukturës gjinore të ankuesve**




**Diagrami nr.2 paraqet të dhënat e tabelës nr.2**

### 5.1.3 .Ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve

Nga 784 ankesa të pranuar në vitin 2019, prej tyre 752 ose 95.91%, janë parashtruar nga ankuesit e përkatësisë etnike shqiptare, ndërsa 23 ankesa ose 2.93%, janë parashtruar nga ankuesit e përkatësisë etnike serbe, 6 ankesa ose 0.76% janë parashtruar nga ankuesit e përkatësisë etnike boshnjake, dhe 3 ankesa ose 0.38% janë parashtruar nga ankuesit e përkatësisë etnike turke.

Nr.rendor	Ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve	Numri i ankesave	Përqindja
1	Shqiptar	752	95.91%
2	Serb	23	2.93%
3	Boshnjak	6	0.76%
4	Turk	3	0.38%

**Tabela nr. 3 paraqet ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve**




**Diagrami nr.3 paraqet të dhënat e tabelës nr.3**

#### **5.1.4. Ankesat e pranuar sipas institucioneve kundër vendimeve të cilave është paraqitur ankesë**

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka pranuar ankesa nga nëpunësit civilë dhe nga kandidatët për pranim në shërbimin civil, të parashtruara kundër vendimeve të organeve të punësimit, si në vijim: 512 ankesa ose 65.30% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë parashtruar kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore si dhe 272 ankesa ose 34.70% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë parashtruar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale.

Nr.	Ankesat e pranuar sipas institucioneve kundër vendimeve të cilave është paraqitur ankesë	Numri i ankesave	Përqindja
1	Institucionet e administratës qendrore	512	65.30%
2	Institucionet e administratës lokale	272	34.70%

**Tabela nr. 4 paraqet ankesat e pranuar sipas institucioneve kundër vendimeve të cilave është paraqitur ankesë.**



**Diagrami nr. 4 paraqet të dhënat e tabelës nr.4**

## 6. ANKESAT E PRANUARA KUNDËR VENDIMEVE TË INSTITUCIONEVE

### 6.1. Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka pranuar 512 ankesa kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, të cilat pasqyrohen si në vijim:

Nr.	Institucionet e Administratës Qendrore	Numri i Ankesave	Përqindja
1	Administrata Tatimore e Kosovës	63	8.04 %
	Ministria e Punëve të Brendshme	38	4.85%
	Ministria e Shëndetësisë	21	2.68%
	Ministria e Infrastrukturës	21	2.68%
	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	21	2.68%
	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	20	2.55%
	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	16	2.04%
	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	15	1.91%
	Ministria e Punëve të Jashtme	14	1.79%
	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	13	1.66%
	Ministria e Financave	13	1.66%
	Ministria e Drejtësisë	12	1.53%
	Këshilli Prokurorial i Kosovës	12	1.53%
	Agjencia Pyjore e Kosovës	11	1.40%
	Agjencia e Statistikave të Kosovës	10	1.28%
	Gjykata Themelore në Gjilan	10	1.28%
	Policia e Kosovës	10	1.28%
	Ministria e Administratës Publike	10	1.28%
	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	9	1.15%
	Shërbimi Korrektues i Kosovës	9	1.15%
	Universiteti i Pejës	8	1.02%
	Agjencia Kosovare e Privatizimit	8	1.02%
	Kuvendi i Republikës së Kosovës	7	0.89%
	Ministria e Integritetit Evropian	7	0.89%
	Agjencia e Navigacionit Ajror	6	0.76%
	Agjencia e Punësimit	6	0.76%
	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	6	0.76%
	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës	6	0.76%
	Biblioteka Kombëtare e Kosovës	5	0.64%
	Gjykata Themelore në Prizren	4	0.51%
	Agjencia Kadastrale e Kosovës	4	0.51%
	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	4	0.51%
	Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike	4	0.51%
	Gjykata Themelore në Mitrovicë	4	0.51%
	Qendra e Studentëve të Universitetit të Prishtinës	4	0.51%
	Autoriteti i Aviacionit Civil	4	0.51%
	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj	4	0.51%

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	4	0.51%
Gjykata Themelore në Prishtinë	3	0.38%
Universiteti i Prishtinës	3	0.38%
Gjykata e Apelit	3	0.38%
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	3	0.38%
Zyra e Kryeministrit	3	0.38%
Gjykata Themelore në Gjakovë	3	0.38%
Inspektorati i Punës	2	0.25%
Akademia e Drejtësisë	2	0.25%
Gjykata Themelore në Pejë	2	0.25%
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	2	0.25%
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	2	0.25%
Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë	2	0.25%
Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës	2	0.25%
Universiteti i Prizrenit	2	0.25%
Gjykata Supreme e Kosovës	2	0.25%
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike	2	0.25%
Muzeu i Kosovës	2	0.25%
Gjykata Themelore në Ferizaj	2	0.25%
Njësia për Intelegjencë Financiare	1	0.13%
Gjykata Kushtetues e Kosovës	1	0.13%
Komisioni rregullativ i prokurimit Publik	1	0.13%
Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale	1	0.13%
Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit	1	0.13%
Universiteti i Gjilanit	1	0.13%
Gjykata Supreme e Kosovës	1	0.13%
Dogana e Kosovës	1	0.13%
Komisioni i Pavarur për Media	1	0.13%
Organi Shqyrtues i Prokurimit	1	0.13%
Prokuroria e Shtetit	1	0.13%
Ministria e Zhvillimit Rajonal	1	0.13%
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	1	0.13%
Agjencia Kosovar për Produkte Medicinale	1	0.13%
Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike	1	0.13%
Agjencia për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	1	0.13%
Institucioni i Avokatit të Popullit	1	0.13%
Agjencia e Menaxhimit Emergjent	1	0.13%
Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës	1	0.13%
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor	1	0.13%
Këshilli i Sigurisë së Kosovës	1	0.13%
Instituti Pedagogjik i Kosovës	1	0.13%
Akademia e Kosovës për Siguri Publike	1	0.13%
Agjencia për Barazi Gjinore	1	0.13%
Agjencia e Shoqërisë së Informacionit	1	0.13%



	Agjencia Kundër Korrupsionit	1	0.13%
	Agjencia e Akreditimit të Kosovës	1	0.13%
	<b>Gjithsejtë:</b>	<b>512</b>	<b>65.30%</b>

**Tabela nr. 5 paraqet të dhënat për numrin dhe përqindjen e ankesave të arritura në Këshill, gjatë vitit 2019, kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore.**

<b>Ankesat e pranuara kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore sipas objektit të ankesës</b>	Kontestim konkursi	Kërkesa nga marrëdhënia e Punës	Transferim	Kompensim material	Masë disiplinore	Ndërprerje e marrëdhënies së punës	Pezullim parandalues	Mos ekzekutim i vendimit të Komisionit të Ankesave	Vlerësim i punës	Shkelje e të drejtës në pagë	Pezullim i dakorduar	Ujje në pozitë	Çështje e avancimit në karrierë	Kundër caktimit të ushtruesit të detyrës	Gjithsejti
Administrata Tatimore e Kosovës	28	14	8	6	5	1							1		63
Ministria e Punëve të Brendshme	22	6	1	7	1						1				38
Ministria e Shëndetësisë	6	1		3	1	5	2	2		1					21
Ministria e Infrastrukturës	8	4	3		2	2	2								21
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	17			3	1										21
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	14	3			2		1								20
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë		9		3		1			1	2					16
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	11	1	2	1											15
Ministria e Punëve të Jashtme	8	4			1	1									14
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	9			1	1				1			1			13
Ministria e Financave	8	1		3		1									13
Ministria e Drejtësisë	8			2						2					12
Këshilli Prokurorial i Kosovës	9	1	1	1											12

Agjencia Pyjore e Kosovës	1	1	1		5	1			2						11
Agjencia e Statistikave të Kosovës	6	1		1		1			1						10
Gjykata Themelore në Gjilan	6	1		3											10
Policia e Kosovës	2	4	2		1				1						10
Ministria e Administratës Publike	8			2											10
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	3		2	3								1			9
Shërbimi Korrektues i Kosovës	4	2		1	2										9
Universiteti i Pejës	6				1				1						8
Agjencia Kosovare e Privatizimit	3	2			1	1		1							8
Kuvendi i Republikës së Kosovës	4			1	2										7
Ministria e Integrimi Evropiane	1	1			4									1	7
Agjencia e Navigacionit Ajror	6														6
Agjencia e Punësimit	6														6
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	2				3				1						6
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës		3	2						1						6
Biblioteka Kombëtare e Kosovës	5														5
Gjykata Themelore në Prizren		2		2											4
Agjencia Kadastrale e Kosovës		1		1			2								4
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	2	1			1										4

Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike	1			1			1							4
Gjykata Themelore në Mitrovicë	2			1	1									4
Qendra e Studentëve të Universitetit të Prishtinës	1	1		1		1								4
Autoriteti i Aviacionit Civil	1	2			1									4
Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj	4													4
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	3				1									4
Gjykata Themelore në Prishtinë	3													3
Universiteti i Prishtinës				2	1									3
Gjykata e Apelit				3										3
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	3													3
Zyra e Kryeministrit	2			1										3
Gjykata Themelore në Gjakovë	1			2										3
Gjykata Supreme e Kosovës				3										3
Inspektorati i Punës	2													2
Akademia e Drejtësisë	1				1									2
Gjykata Themelore në Pejë	1			1										2
Paneli Zgjedhor për ankesa dhe parashtrës					1	1								2
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave		1		1										2
Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë	1		1											2
Agjencia Shtetërore e Aktivave të	1		1											2



Agjencia Kosovare për krahasim dhe Verifikim të Pronës	1														1
Institucioni i Avokatit të Popullit	1														1
Agjencia e Menaxhimit Emergjent	1														1
Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës									1						1
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	1														1
Këshilli i Sigurisë së Kosovës					1										1
Instituti Pedagogji i Kosovës				1											1
Akademia e Kosovës për Siguri Publike	1														1
Agjencia për Barazi Gjinore	1														1
Agjencia e Shoqërisë së Informacionit			1												1
Agjencia Kundër Korrupsionit									1						1
Agjencia e Akreditimit të Kosovës	1														1
<b>Gjithsejt:</b>	<b>259</b>	<b>70</b>	<b>28</b>	<b>64</b>	<b>41</b>	<b>17</b>	<b>8</b>	<b>3</b>	<b>10</b>	<b>6</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>512</b>

**Tabela nr.6 paraqet ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, sipas objektit të ankesave**

## 6.2. ANKESAT E PRANUARA KUNDËR VENDIMEVE TË INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS LOKALE

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka pranuar 272 ankesa të cilat janë parashtruar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale, e të cilat pasqyrohen si në vijim.

Nr.	Institucionet e administratës	Numri i ankesave	Përqindja
1	Komuna e Prishtinës	44	5.61%
2	Komuna e Prizrenit	30	3.83%
3	Komuna e Mitrovicës	27	3.44%
4	Komuna e Ferizajt	16	2.04%
5	Komuna e Kamenicës	15	1.91%
6	Komuna e Obiliqit	13	1.66%
7	Komuna e Klinës	13	1.66%
8	Komuna e Gjilanit	11	1.40%
9	Komuna e Istogut	10	1.28%
10	Komuna Skenderajt	9	1.15%
11	Komuna e Malishevës	8	1.02%
12	Komuna e Kllkotit	8	1.02%
13	Komuna e Drenasit	8	1.02%
14	Komuna e Gjakovës	7	0.89%
15	Komuna e Rahovecit	7	0.89%
16	Komuna e Leposaviqit	6	0.77%
17	Komuna e Vitisë	6	0.77%
18	Komuna e Suharekës	6	0.77%
19	Komuna e Lipjanit	5	0.64%
20	Komuna e Podujevës	4	0.51%
21	Komuna e Kaçanikut	4	0.51%
22	Komuna e Fushë Kosovës	4	0.51%
23	Komuna e Shtimes	4	0.51%
24	Komuna e Vushtrrisë	2	0.25%
25	Komuna e Pejës	2	0.25%
26	Komuna e Shtërpcës	2	0.25%
27	Komuna e Graçanicës	1	0.13%
	<b>Gjithsejtë:</b>	272	34.70%

Tabela nr.7 Paraqet të dhënat për numrin dhe përqindjen e ankesave të pranuar në Këshill, gjatë vitit 2019, kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale

Ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale sipas objektivit të ankesave	Kontestim konkursi	Kompensim material	Ndërprejje e marrëdhënies së punës	Transferim	Masë disiplinore	Pezullim parandalues	Shkelje e të drejtës në pagë	Kërkesa nga marrëdhënia e punës	Vlerësim i punës	Mos ekzekutim i vendimit të Komisionit të Ankesave	Gjithsejtë
Komuna e Prishtinës	14	9	7	8				6			44
Komuna e Prizrenit	19	5	1	1	1	1	1	1			30
Komuna e Mitrovicës	21	2	2			1		1			27
Komuna e Ferizajt	6	6			2			2			16
Komuna e Kamenicës	9		1	1	1	1		1	1		15
Komuna e Obiliqit	7	1	2	2				1			13
Komuna e Klinës	12	1									13
Komuna e Gjilanit	4		4	2		1					11
Komuna e Istogut	10										10
Komuna Skenderajt	6	1		1	1						9
Komuna e Malishevës	8										8
Komuna e Klllokotit			4		2				2		8
Komuna e Drenasit	4	1		1		1		1			8
Komuna e Gjakovës	3		1	1	2						7
Komuna e Rahovecit	4		3								7
Komuna e Leposaviqit	6										6
Komuna e Vitisë	4	1	1								6
Komuna e Suharekës	5	1									6
Komuna e Lipjanit	4			1							5
Komuna e Podujevës	1	3									4
Komuna e Kaçanikut	1	1	1					1			4
Komuna e Fushë Kosovës	1	1			1			1			4
Komuna e Shtimes	1			1	1			1			4
Komuna e Vushtrrisë	1		1								2
Komuna e Pejës	1									1	2



Komuna e Shtërpcës			2								2
Komuna e Graçanicës					1						1
<b>Gjithsejt:</b>	<b>152</b>	<b>33</b>	<b>30</b>	<b>19</b>	<b>12</b>	<b>5</b>	<b>1</b>	<b>16</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>272</b>

**Tabela nr.8 paraqet ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale sipas objektit të ankesave**

## 7. NDARJA E ANKESAVE SIPAS MËNYRËS SË VENDOSJES

Këshilli, gjatë vitit 2019, ka shqyrtuar dhe ka vendosur për gjithsej 49 ankesa, si në vijim:

### 7.1 Të aprovuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, që në bazë të provave dhe fakteve, Këshilli i ka aprovuar dhe ka anuluar vendimet e organeve të punësimit, duke i obliguar organet e punësimit për zbatimin e vendimeve të Këshillit në afatin e përcaktuar ligjor.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka aprovuar **(8)** ankesa.

### 7.2 Pjesërisht të aprovuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit të cilat kanë dy e më shumë pretendime ankimore dhe për të cilat Këshilli në bazë të provave dhe fakteve të ofruara nga ankuesit dhe nga organet e punësimit ka vendosur për aprovimin e pjesërishtëm të ankesës.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka aprovuar pjesërisht **(4)** ankesa.

### 7.3 Të refuzuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, të cilat Këshilli i ka refuzuar si të pabazuara në bazë të provave dhe fakteve të paraqitura nga ankuesit dhe organet e punësimit, duke lënë në fuqi vendimet e organeve të punësimit.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka refuzuar **(13)** ankesa.

### 7.4 Të hedhura poshtë si të palejuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, të cilat Këshilli i ka hedhë poshtë si të palejuara sepse nuk janë shterur mjetet e brendshme të ankimit, janë parashtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjor për ankim, apo janë parashtruar nga personat që në bazë të ligjit nuk konsiderohen palë në procedurë. Këshilli gjatë periudhës raportuese ka hedhur poshtë si të palejuara **(8)** ankesa.

### 7.5 Të shpallura jo-kompetent

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit për të cilat Këshilli ka vendosur që të shpallet jo-kompetent, për shkak se ankesat janë parashtruar nga personat të cilët nuk e kanë statusin e nëpunësit civil ose nuk janë kandidatë për pranim në shërbimin civil.

Këshilli gjatë periudhës raportuese është shpallur jo kompetent për **(7)** ankesa.

## 7.6 Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ

Janë vendime me të cilat Këshilli i detyron organet e punësimit, respektivisht komisionet përkatëse për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave për të vendosur për ankesën e ankuesit, në rastet kur nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka nxjerr vendime për detyrimin e organeve të punësimit për të vendosur, për (3) ankesa.

## 7.7 Kthimi në rishqyrtim

Janë vendime me të cilat, Këshilli ka vendos për kthimin e lëndës në rishqyrtim tek organet e punësimit për të gjitha rastet kur në bazë të provave dhe fakteve të ofruara nga ankuesit dhe nga organet e punësimit, Këshilli ka konstatuar se nëse lënda kthehet në rishqyrtim tek organi i punësimit do të evitohen gabimet të cilat nuk konsiderohen si shkelje të rënda procedurale. Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për kthimin e lëndës në rishqyrtim për (5) ankesa.

## 7.8 Përfundim i procedimit administrativ


Janë vendime të cilat Këshilli i nxjerr për të gjitha rastet kur ankuesit i tërheqin ankesat ose kur Këshilli konstaton se objekti për të cilin kishte filluar procedimi ose qëllimi i vendimit është bërë i pamundur

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për përfundimin e procedimit administrativ për (1) ankesa.

Në tabelën në vijim paraqitet në mënyrë tabelare, mënyra e vendosjes nga Këshilli për 49 ankesa, numri i ankesave të vendosura si dhe përqindja në krahasim me numrin e përgjithshëm të ankesave të vendosura.

Mënyra e vendosjes	Numri i ankesave	Përqindja
Të refuzuara	13	26.53%
Të aprovuara	8	16.33%
Të hedhura poshtë si të palejuara	8	16.33%
Shpallja jo kompetent	7	14.28%
Kthimi në rishqyrtim	5	10.20%
Të aprovuara pjesërisht	4	8.16%
Detyrim për vendosje	3	6.12%
Përfundim i procedimit administrativ	1	2.04%
<b>Gjithsejtë</b>	<b>49</b>	<b>100%</b>

**Tabela nr. 9 paraqet mënyrën e vendosjes së ankesave nga Këshilli, numrin e ankesave sipas mënyrës së vendosjes dhe përqindjen në krahasim me numrin e përgjithshëm të ankesave**



Diagrami nr. 5 paraqet të dhënat e tabelës nr.9

## 8. FORMAT E VENDOSJES KUNDËR VENDIMEVE TË INSTITUCIONEVE

Në këtë pjesë të raportit, paraqiten të dhënat për formën e vendosjes nga Këshilli, lidhur me ankesat e parashtruara kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore dhe lokale.

### 8.1 Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka vendosur për **24** ankesa të parashtruara kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, gjegjësisht për **1** ankesa të vitit 2019 , dhe për **23** ankesa të bartura nga viti 2018 në vitin 2019.

<b>Institucionet e Administratës Qendrore</b>	<b>Të refuzuara</b>	<b>Pjesërisht të aprovuara</b>	<b>Të hedhura poshtë si të palejuara</b>	<b>Shpallja jo kompetent</b>	<b>Kthimi në rishqyrtim</b>	<b>Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ</b>	<b>Numri i ankesave të shqyrtuara</b>
Agjencia Pyjore e Kosovës			3				3
Administrata Tatimore e Kosovës				1	1		2
Ministria e Punëve të Brendshme	1		1				2
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	1				1		2
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës						2	2
Agjencia e Statistikave të Kosovës	1			1			2
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor			2				2
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1						1
Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale		1					1
Autoriteti i Aviacionit Civil	1						1
Universiteti i Mitrovicës				1			1
Policia e Kosovës				1			1
Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë			1				1
Universiteti i Gjilanit	1						1
Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike Postar					1		1
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	1						1
<b>Gjithsejtë:</b>	<b>7</b>	<b>1</b>	<b>7</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>24</b>

**Tabela nr.10 paraqet format e vendosjes për ankesat e shqyrtuara dhe të vendosura gjatë vitit 2019 kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore**

## 8.2.Format e vendosjes së ankesave kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka vendosur për 25 ankesa të parashtruara kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale,

Institucionet e Administratës Lokale	Të aprovuara	Të refuzuara	Të hedhura poshtë si të palejuara	Shpallja jo kompetent	Kthimi në rishqyrtim	Përfundim i procedimit administrativ	Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ	Numri i ankesave të shqyrtuara
Komuna e Prishtinës		2		1			1	4
Komuna e Prizrenit	1	1	1	1				4
Komuna e Istogut	2	1						3
Komuna e Ferizajt	1			1				2
Komuna e Podujevës	2							2
Komuna e Obiliqit					2			2
Komuna e Klllokotit	1							1
Komuna e Kaçanikut			1					1
Komuna e Parteshit		1						1
Komuna e Mitrovicës		1						1
Komuna e Pejës			1					1
Komuna e Fushë Kosovës			1					1
Komuna e Dragashit	1							1
Komuna e Suharekës						1		1
Gjithsejtë:	8	6	4	3	2	1	1	25

**Tabela nr.11 paraqet format e vendosjes për ankesat e shqyrtuara dhe të vendosura gjatë vitit 2019 kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale**

## 9. ZBATIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT NGA ORGANET E PUNËSIMIT

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, organet e punësimit që kanë të punësuar nëpunës civilë janë të obliguara për zbatimin e vendimeve të Këshillit.

Vendimet e Këshillit janë vendime administrative të formës së prerë dhe duhet të zbatohen nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që ka nxjerrë vendimin e parë ndaj palës.

Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

Organet e punësimit për vitin 2019, kanë pasur obligim ligjor për të zbatuar 20 vendime të Këshillit, prej tyre 12 vendime përfundimtare dhe 8 vendime të ndërmjetme, si në vijim:


- **8** vendime përfundimtare me të cilat janë aprovuar ankesat;
- **4** vendime përfundimtare me të cilat janë aprovuar pjesërisht ankesat;
- **3** vendime të ndërmjetme me të cilat organet e punësimit janë obliguar që të nxjerrin aktin administrative; dhe
- **5** vendime të ndërmjetme me të cilat organet e punësimit janë obliguar që të rishqyrtojnë vendimet e tyre.

Përkundër faktit që vendimet e Këshillit janë vendime të formës së prerë në procedurë administrative, nga njoftimet që Këshilli ka pranuar nga organet e punësimit dhe ankuesit rezulton që organet e punësimit nga 12 vendime përfundimtare kanë zbatuar 10 vendime, ndërsa 2 vendime nuk janë zbatuar.

Ndërsa nga 8 vendime të ndërmjetme janë zbatuar 8 vendime, që do të thotë që janë zbatuar të gjitha.

Vendimet e Këshillit për ankesat	Numri i vendimeve për zbatim	Vendimet e zbatuara	Vendimet e pa zbatuara	Vendime ne proces te zbatimit	Numri i vendimeve të pezulluara me vendim të Gjykatës
Të aprovuara	8	6	2	0	0
Pjesërisht të aprovuara	4	4	0	0	0
Gjithsejtë:	12	10	2	0	0


**Tabela nr. 12 paraqet numrin e ankesave për vendimet Përfundimtare, vendimet e zbatuara, vendimet e pazbatuara si dhe vendimet e pezulluara me vendim të gjykatës**



**Diagrami nr.6 paraqet të dhënat e tabelës nr.12**

Vendimet e Këshillit ankesat për	Numri i vendimeve për zbatim	Vendimet e zbatuara	Vendimet e pa zbatuara	Vendime ne proces të zbatimit	Numri i vendimeve të pezulluara me vendim të Gjykatës
Kthimi në rishqyrtim	5	5	0	0	0
Detyrim për vendosje	3	3	0	0	0
<b>Gjithsejtë:</b>	8	8	0	0	0

**Tabela nr. 13 paraqet numrin e vendimeve te ndërmjetme, vendimet e zbatuara, vendimet e pazbatuara si dhe vendimet e pezulluara me vendim të gjykatës**



**Diagrami nr.7 paraqet të dhënat e tabelës nr.13**

Nr.	Institucionet e administratës qendrore	Numri i vendimeve të pazbatuara	Numri referues i vendimit	Personi përgjegjes për zbatim
1	Komuna e Podujevës	1	A.nr.825/2018	Kryetari i komunës
2	Komuna e Podujevës	1	A.nr.833/2018	Kryetari i komunës
	<b>Gjithsejtë:</b>	2		

**Tabela nr.14 paraqet institucionet e administratës qendrore dhe lokale që nuk i kanë zbatuar vendimet e Këshillit si dhe numrin e vendimeve të pa zbatuara.**



**10.FUNKSIONI I MBIKËQYRJES SË PËRZGJEDHJES TË NËPUNËSVE CIVIL TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES DHE TË NIVELIT DREJTUES**

Funksioni i mbikëqyrjes së procedurave të përzgjedhjes të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues është i përcaktuar me nenin 19 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Në pajtim me këto dispozita, Këshilli është kompetent për të vendosur nëse procedura e emërimit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues është zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e përcaktuara me legjislacionin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me këtë dispozitë ligjore, organet e punësimit, janë të obliguara që të njoftojnë Këshillin, për të mbikëqyrur procesin e avancimit ose të rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues.

Këshilli gjatë vitit 2019 ka mbikëqyrur 19 procedura të lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues.

Nga 19 pozita që janë mbikëqyrur, Këshilli ka anuluar 19 procedura të rekrutimit për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale.

Në vijim janë paraqitur në mënyrë tabelore, institucionet dhe numri i pozitave të nëpunësve civilë të nivelit drejtues të cilat janë mbikëqyr nga Këshilli, si dhe mënyrën e vendosjes për këto procedura. Të verifikohet se procedurat e më poshtëme janë anuluar nga institucioni ose nga këshilli

<b>Nr. rendor</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Pozita</b>	<b>Nr.i vendimit</b>	<b>Numri i Pozitave te anuluar</b>
<b>1</b>	Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë	1. Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme 2. Drejtor i Departamentit të Turizmit 3. Menaxher i Cilësisë	V.Nr.32/2019 V.Nr.34/2019 V.Nr.48/2019	<b>3</b>
<b>2</b>	Komuna e Lipjanit	1.Udhëheqës i Sektorit për Mirëqenie Sociale	V.Nr.35/2019	<b>1</b>
<b>3</b>	Agjencia Pyjore e Kosovës	1.Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Pyjeve	V.Nr.33/2019	<b>1</b>
<b>4</b>	Komuna e Mitrovicës	1.Drejtor i qendrës për Punë Sociale	V.Nr.20/2019	<b>1</b>
<b>5</b>	Ministria e Drejtësisë	1.Udhëheqës i Divizionit për drejtësi Tranzicionale 2.Udhëheqës i Divizionit për Mbështetjen e Viktimave të Kthimit	V.Nr.121/2019 V.Nr.122/2019	<b>2</b>
<b>6</b>	Komuna e Kaçanikut	1.Zëvendës Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët Emin Duraku	V.Nr.26/2019	<b>1</b>

7	Këshilli Prokurorial i Kosovës	1. Udhëheqës i Zyrës së Pagave	V.Nr.85/2019	1
8	Komuna e Suharekës	1. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Bajram Curri” 2. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Iliria” 3. Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Dituria”	V.Nr.477/2018 V.Nr.478/2018 V.Nr.479/2018	3
9	Ministria e Integrimiave Evropiane	1. Udhëheqës i Divizionit për Zhvillim Rajonal dhe Statistika 2. Drejtor i Departamentit të Drejtës së BE-së	V.Nr.466/2018 V.Nr.28/2019	2
10	Presidenca e Kosovës	1. Drejtor i Departamentit të Informacionit dhe Komunikim me Publikun	V.Nr.38/2019	1
11	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësis h	1. Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme 2. Udhëheqës i Divizionit të Ndërmarrësis 3. Udhëheqës i Divizionit për Inovacion	V.Nr.144/2019 V.Nr.145/2019 V.Nr.146/2019	3
<b>Gjiths ejtë</b>				<b>19</b>

**Tabela nr. 15. Në këtë tabelë pasqyrohen procedurat e mbikëqyrjes së emërimit të nëpunësve civilë në pozitë të nivelit të lartë drejtues dhe nivelit drejtues të rekrutimit të cilat janë anuluar për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale.**

## **11. FUNKSIONI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL**

Sic është sqaruar më lartë ky funksion nuk ka pasur mundësi të realizohet për shkak të mungesës së anëtarëve të KPMSHCK-së.

## **12. REKOMANDIMET DHE SFIDAT E KËSHILLIT**

Nuk ka rekomandime sepse rekomandimet vendosen nga anetarët e KPMSHCK-se

## **13. VENDIMET E GJYKATAVE**

Këshilli gjatë vitit 2019 ka pranuar 341 vendime nga gjykatat e vendit, prej tyre 235 aktgjykime dhe 106 aktvendime.

Këshilli konstaton se me 169 Aktgjykime të gjykatave të vendit janë refuzuar kërkesëpaditë e paditësve kundër vendimeve të Këshillit, duke u vërtetuar vendimet e Këshillit.

Me 37 Aktgjykime të gjykatave të vendit janë aprovuar kërkesëpaditë e paditësve kundër vendimeve të Këshillit duke u anuluar 37 vendime të Këshillit të cilat janë kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshill.

Me 13 Aktgjykime gjykatat e vendit duke vendosur në mënyrë përfundimtare ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve dhe janë anuluar vendimet e Këshillit.

Me 13 aktgjykim, Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesën e Këshillit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Me 3 aktgjykime, Gjykata e Apelit ka refuzuar aprovuar ankesën e palës dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim në Gjykatën Themelore në Prishtinë

Prej 106 aktvendimeve që kemi pranuar nga Gjykatat gjatë vitit 2019, gjendja pasqyrohet si në vijim:

- me 2 Aktvendime, Gjykatat kanë aprovuar kërkesat e palëve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Këshillit.
- me 4 Aktvendime, Gjykatat kanë refuzuar kërkesat e palëve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Këshillit.
- me 51 Aktvendime, Gjykata Themelore në Prishtinë ka pezulluar procedurën gjyqësore pasi që pala nuk ka pasur interes me vazhduar procedurën;
- me 21 Aktvendime janë hedhur poshtë paditë e ushtruara kundër vendimeve të Këshillit;
- me 9 Aktvendime është lejuar tërheqja e padive të ushtruara kundër vendimeve të Këshillit;
- me 7 Aktvendime Gjykata e Apelit e Kosovës ka aprovuar ankesën e palës duke e kthyer lëndën në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë;

- me 4 Aktvendime Gjykata e Apelit e Kosovës ka aprovuar ankesën e Këshillit duke e kthyer lëndën në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë
- me 5 Aktvendime Gjykata e Apelit e Kosovës ka refuzuar ankesën e Këshillit;
- me 1 aktvendim Gjykata Themelore në Prishtinë është shpall jo kompetent për të vendosur;
- me 1 Aktvendim është bërë korrigjimi i aktgjykimit;
- me 1 Aktvendim është caktuar ekspertiza

Aktgjykimet dhe aktvendimet e Gjykatës janë nxjerr për vendimet e Këshillit gjatë viteve paraprake, por që janë vendosur nga Gjykata në vitin 2019.

#### **14.BASHKËPUNIMI I KËSHILLIT ME INSTITUCIONET TJERA**

Edhe pse në mungesë të pesë anëtarëve ne jemi munduar të bashkëpunojm me të gjitha institucionet relavante.

#### **15.KRAHASIMI I PUNËS SË KËSHILLIT PËR VITIN 2019 ME PUNËN E KËSHILLIT PËR VITIN 2018**

##### **15.1.Funksioni i shqyrtimit të ankesave**

Në tekstin në vijim do të paraqiten të dhënat për punën e Këshillit për vitin 2019 në krahasim me punën e Këshillit për vitin 2018, në pajtim me kërkesën dhe formatin e raportit të punës.

Në vitin 2019 në Këshill janë pranuar gjithsej 784 ankesa kurse në vitin 2018 në Këshill janë pranuar 863 ankesa. Nga kjo e dhënë, konstatohet që në Këshill gjatë vitit 2019 janë pranuar 79 ankesa më pak se ankesat e pranuar në vitin 2018.

Këshilli, gjatë vitit 2019 ka pasur në shqyrtim 896 ankesa dhe prej tyre ka vendosur për 49 ankesa, në krahasim në vitin 2018 kur ka pasur në shqyrtim 937 ankesa prej të cilave ka vendosur për 825. Nga kjo rezulton që Këshilli gjatë vitit 2019 ka vendosur për 888 ankesa me pak se sa në vitin 2018.

Këshilli gjatë vitit 2018 ka pasur në shqyrtim 937 ankesa ndërsa në vitin 2019 ka pasur në shqyrtim 896 ankesa. Nga kjo rezulton se Këshilli gjatë vitit 2019 ka pasur në shqyrtim 41 ankesa më pak se në vitin 2018.

Nga viti 2019 në vitin 2020 janë bartur 787 ankesa më shumë se ankesat e bartura nga viti 2018 në vitin 2019.

Në vitin 2019 organet e punësimit kanë pasur për obligim zbatimin e 20 vendimeve të Këshillit, prej 20 vendimeve, organet e punësimit kanë zbatuar 17 vendime, nuk kanë zbatuar 2 vendime, ndërsa në proces të zbatimit janë edhe 1 vendime.

Nr.	Ankesat/Vendimet	Viti 2019	Viti 2018	Ndryshimi	Krahasimi i ankesave dhe vendimeve në mes të vitit 2019 dhe 2018
1.	Ankesat e pranuar	784	863	79	Këshilli në vitin 2019 ka pranuar 79 ankesa më pak se në vitin 2018
2.	Ankesat për shqyrtim në Këshill	896	937	44	Këshilli në vitin 2019 ka pasur në shqyrtim 41 ankesa më pak se në vitin 2018
3.	Ankesat e shqyrtuara në Këshillit (Numri i vendimeve)	49	825	776	Këshilli në vitin 2019 ka nxjerrë 776 vendime më pak se në vitin 2018
4.	Vendimet e obligueshme për zbatim	20	286	266	Organet e punësimit në vitin 2019 kanë pasur obligim për zbatimin e 20 vendimeve, ndryshimi nga viti 2018 vitin 2019 është për 266 vendime.
5.	Vendimet e zbatuara	17	253	236	Numri i vendimeve të zbatuara është 17
6.	Vendimet e pazbatuara	2	15	13	Në vitin 2019 kanë qenë 2 vendime të pazbatuara
7.	Ankesat e bartura në vitin vijues	787	112	675	Nga viti 2019 në vitin 2020 janë bartur 675 ankesa më shumë se nga viti 2018 në vitin 2019

**Tabela nr.16 paraqet krahasimin e ankesave të pranuar, ankesave në shqyrtim si dhe vendimet e nxjerra gjatë vitit 2019 dhe 2018.**

### **15.2. Funkzioni i mbikëqyrjes të procedurës së rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues dhe nivelit të lartë drejtues**

Këshilli gjatë vitit 2019 ka mbikëqyrur 19 procedura për procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues dhe të nivelit të lartë drejtues. Nga 19 procedura që janë mbikëqyrur, Këshilli ka anuluar 19 procedura të rekrutimit për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale.

Kur i krahasojmë të dhënat e më poshtme konstatohet që Këshilli në vitin 2019 ka mbikëqyrur 428 procedura të rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues dhe të nivelit të lartë drejtues më pak se në vitin 2018, kjo ka ndodhur se rrjedh e mungesës së korumit, si dhe nga data 20.05.2019 këtë funksion të KPMSHCK-së e ka shfuqizuar Gjykata Kushtetuese. Prandaj këto procedura të vëzhgimit në Këshill janë pranura para se të shpallet Aktgjukimi Nr.ref.AGJ 1363/19

Nr.	Procedura e mbikëqyrjes	Viti 2019	Viti 2018	Ndryshimi	Krahasimi i procedurës së mbikëqyrjes
1	Procedurat e mbikëqyrjes lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues dhe të nivelit të lartë drejtues	19	447	428	Këshilli në vitin 2019 ka mbikëqyrrur 428 pozita të rekrutimit më pak se në vitin 2018
3	Procedurat e anuluar	19	222	203	Këshilli në vitin 2019 ka anuluar 203 pozita të rekrutimit më pak se në vitin 2018.

**Tabela nr.17 paraqet krahasimin e procedurës së mbikëqyrjes për vitin 2019 dhe 2018**

### 15.3.Funksioni i monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil

Nuk është realizuar, për shkaqet e lartëshenuara.

**16. RAPORTI PËR SHPENZIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT**

Buxheti fillestar i aprovuar për Këshillin, sipas Ligjit 06/L-133 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, ka qenë në shumën prej :393.576.00 Euro.

Sipas ligjit buxheti i Këshillit është ndarë në këto kategori ekonomike:

**Në kategorinë ekonomike Paga dhe Mëditje:** Buxheti i aprovuar është në shumë: **272.393.00€**

**Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime:** Buxheti i aprovuar është në shumë:  
 .....**117.358.00€**

**Në kategorinë ekonomike Shpenzime komunale:** Buxheti i aprovuar është në shumë:.....**3.825.00€**

<b>Nr</b>	<b>Kategoritë Ekonomike</b>	<b>Buxheti fillestar aprovuar sipas Ligjit 06/L-133 A</b>	<b>Buxheti i rishikuar B</b>	<b>Ndryshimi C=A-B</b>	<b>Buxheti Final-SIMFK D=B</b>
<b>1</b>	<b>Paga dhe mëditje</b>	272.393.00	207.823.59	(64.569.41)	207.823.59
<b>2</b>	<b>Mallra dhe shërbime</b>	117.358.00	117.358.00	00	117.358.00
<b>3</b>	<b>Shpenzime komunale</b>	3.825.00	3.825.00	00	3.825.00
<b>4</b>	<b>Shpenzime kapitale</b>	00	00	00	00
	<b>Totali</b>	<b>393.576.00</b>	<b>329.006.59</b>	<b>(64.569.41)</b>	<b>329.006.59</b>

**Tabela nr. 19 paraqet Ndarjen dhe alokimin e mjeteve sipas kategorive ekonomike**

Nga tabela e nr.24, shihet qartë se ka dallim (ndryshim) në mes të buxhetit të fillestar dhe buxhetit final si SIMFK.

Nga pasqyra e cekur më lartë, shohim se ka ndryshim në mes buxhetit fillestar(ndarja),dhe buxhetit final (SIMFK),në shumë prej:64.569.41euro, Qeveria me vendim nr.03/115,date 17.12.2019,Keshillit ia ka marr shumën prej:(64.569.41).euro nga kategoria Paga dhe shtesa.

Gjatë vitit 2019, nga buxheti i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Këshilli ka shpenzuar në total: **81.79%** të buxhetit. Buxheti i shpenzuar në kategoritë ekonomike është si

vijon:

**Në kategorinë ekonomike Paga dhe Mëditje:** Buxheti është shpenzuar në masën prej 76.30%.

**Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime:** Buxheti është shpenzuar në masën **95.39 %**.

**Në kategorinë ekonomike Shpenzime komunale:** Buxheti është shpenzuar në masën **46.91%**.

Nr.	Kodi buxhetor 249	Buxheti final 2019	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i pa-shpenzuar	Të shprehura në%
1	Paga dhe mëditje	207.823.59	207.823.59	00	76.30%
2	Mallra dhe shërbime	117.358.00	111.953.23	5.404.77	95.39%
3	Shpenzime komunale	3.825.00	1.794.18	2.030.82	46.91 %
4	Shpenzime kapitale	00	00	00	00
	<b>Totali</b>	<b>393.576.00</b>	321.895.04	7.435.59	81.79%

Tabela nr. 20 paraqet shpenzimet e buxhetit sipas kategorive ekonomike